

Ajo që më pëlqen te vajza ime, Sara, e cila është katërmëdhjetë vjeçe, parashtimi i pyetjes për çdo gjë që e ka rëndë ta kuptojë dhe kujdesi për ta shtuar diapazonin e kulturës duke lexuar në kohën e lirë.

Një natë prej netëve të kësaj vere, kohë në të cilën nuk ka shkollë as detyra shtëpiake, Sara lexonte me zë të vogël Kur'anin, saqë ata që janë përreth nuk mund ta dëgjonin zërin e saj.

Befas, Sara e mbylli mus'hafin duke e vënduar gishtin në vendin ku kishte mbetur duke lexuar dhe u drejtua me gjithë fytyrën nga unë duke më thënë, baba, baba...

Iu përgjigja: *Urdhëro bija ime!*

Tha: *A më ke thënë se në Islam ka barazi ndërmjet mbarë muslimanëve dhe nud ka dallim mes tyre?*

I thashë: *Po, Sara!*

Tha: *Mirëpo tani lexova fjalën e Allahut [subhanehu ve tealala]:*

"All-llahu ju urdhëron për (çështjen e trashëgimit) **fëmijët tuaj: për mashkullin hise sa për dy femra..."**.

(En-Nisa: 11).

Vallë, sipas këtij ajeti a nuk ka dallim mes djemve dhe vajzave?

I thashë: *Nuk ka dallim mes djemve dhe vajzave, çupa ime!*

Më tha: *E si, o babai im i dashur?*

I thashë: *Vazhdo, lexo tani suren En-Nisa, nesër do ta sqaroj se ajeti nuk ban dallim mes djemve dhe vajzave, me leje të All-llahut.*

Më tha: *Si kuptove se jam duke lexuar në suren En-Nisa?*

I thashë: *Sepse ajeti për të cilin je duke pyetur është prej sures En-Nisa.*

Iu kthye Sara mus'hafit për të vazhduar leximin në te pasiqë shpreha kënaqësinë time ndaj saj, sepse kujdesej që të kupton dhe të bindet me atë që e lexon.

* * *

Në mëngjesin e ditës së nesërme, më erdhi djali im Bera dhe më tregoi se dëshiron të shkojë në cirk për tu dëfryer me lojërat e ndryshme që prezentohen atje.

E pyeta: *A do të shkosh vetë?*

Tha: *Do ta marr edhe Sarën me vete.*

I thashë: *Shumë mirë. Meri këto dhjetë dinarë e harxhoi për ty dhe për Sarën... dhe mos lejo që të shpenzon ndonjë dinarë prej parave të saja.*

Pastaj e thirra Sarën dhe i tregova se vëllai i saj do ta merr me vete në cirk, tenda e së cilit ishte vënduar në parkun afër shtëpisë sonë. Sara u gëzua shumë dhe më falënderoj, kurse unë ia dhashë pesë dinarë që të blen çka dëshiron gjatë qëndrimit në cirk.

* * *

Të gjithë ishim ulur në tryezën e ushqimit të drekës, për të ngrënë atë që kishte përgatitur gruaja ime, nëna e Berait.

Pyeta Berain dhe Sarën: *A u kënaqët në cirk?*

U përgjigj Sara më entuziazëm: *Po, shumë baba.*

I thashë: *Çka të pëlqeu më shumë?*

Tha: *Të ecurit e tyre mbi litar të lartë pa u rëzuar, qëndrimi i tyre në biçikleta me motor të shpejta, elefanti i cili ishte ushtruar shumë mirë... të them më drejtë, të gjitha pikat e shfaqjes më pëlqyen.*

I thashë: *Shpresoj se të kanë mjaftuar pesë dinarët.*

Më tha: *I kam me vete, asnjë dinarë nuk kam harxhuar!*

I thashë: *Si ka mundësi, a nuk gjete asgjë për të blerë?*

Sara duke shikuar drejt vëllait të vet tha: *Po babai im, mirëpo Berai insistoi që ai t'i pagujë të gjitha.*

I thashë: *Edhe biletën?*

Tha: *Edhe biletën ma bleu vëllai.*

Iu drejtova Berait dhe e pyeta: *Sa dinarë të kanë mbetur prej atyre dhjetë dinarëve që t'i dhashë?*

Më tha: *Vetëm një.*

Iu drejtova Sarës dhe i thashë: *Tani do të përgjigjem për pyetjen që e parashtrove mbrëmë. Sot në mëngjes vëllait tënd i dhashë dhjetë dinarë, kurse ty t'i dhashë vetëm pesë. Domethënë vëllait tënd i dhashë dyfish më shumë se ty, mirëpo e porosita që të mos lejojë të shpenzosh asgjë për gjërat të cilat i lakmon t'i blejsh. Kështu që atij i mbeti vetëm një dinar, kurse ty të kanë mbetur pesë dinarët të plota.*

Më tha Sara: *Sa madhështor je babai im.*

I thashë: *All-llahu është Madhështor, bija ime. Kur All-llahu [subhanehu ve teala] ka urdhëruar t'i jipet djalit sa dyfish vajzës, siç pate lexuar në ajetin Kur'anor, e ka urdhëruar burrin që të shpenzojë për gruan e vet dhe t'ia plotëson të gjitha nevojat, mu ashtu sikurse e urdhërova vëllain tënd që të të blejë çdo gjë që të nevojitet.*

Tha: *Kurse gruas i mbeten shumica e pasurisë që e merr, kurse shumica e pasurisë së burrit harxhohet edhe pse merr dyfish.*

I thashë: *Mu ashtu siç ndodhi me ty dhe vëllain tënd.*

Tha: *Dëshirove të më përgjigjesh praktikisht që ta kuptoj më mirë, të bindem dhe mos ta harroj asnjëherë...*

I thashë: *Po, bija ime... Kjo ishte dëshira ime.*

Tha: *Shumë të falënderoj dhe të nderoj!*

I thashë: *All-llahu të dhashtë sukses, bija ime dhe ta shtoftë kuptimin e fesë së All-llahut të Lartësuar!*

Pjesa e parë nga libri me titull:
Bisedë me vajzën time
nga: Muhamed Reshid El-Uvejid
përktheu: Bekir Halimi
Muhamed Reshid El-Uvejid,

Kur të lexoni këtë broshurë, bëni vepër të mirë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njejtën!

On-line versionin e këtij teksti mund ta gjeni në:
<http://www.albislam.com/>

Boton:
Shoqata Qytetare
Klubi Studentor
Rr. Stiv Naumov 7 / 18
Tel. ++389 (02) 223-654
1000, Shkup



Sara pyet për të kuptuar dhe mësuar

